



KOLEGJI FAMA/COLLEGE FAMA

Tel: + 381 (0) - 38 -222 – 212
+ 377 (0) - 44 -507 – 080

Web: www.unifama.com
Mail: info@kolegijfama.eu

L A J M Ě R I M PËR PRAKTIKË NË *ProCredit Bank*

Do të dëshironim t'i njoftojmë të gjithë studentët të cilët i plotësojnë kriteret e cekura më poshtë për mundësinë e aplikimit për punë praktike (internship) në ProCredit Bank. Puna praktike, e cila paguhet, planifikohet të fillojë nga 1 Janar deri më 31 Mars, 2010. Gjatë punës praktike studentët e suksesshëm kërkohet të punojnë me orar të plotë gjatë periudhës tremujore.

Procesi i rekrutimit të studentëve (që përfshin fazën e selektimit, testimit, dhe intervistimit) do të organizohet gjatë muajit Nëntor & Dhjetor, 2009.

Ne i inkurajojmë të gjithë studentët e interesuar të aplikojnë. Shumë studentë të cilët e kanë përfunduar praktikën në ProCredit Bank, tashmë janë staf shumë i suksesshëm në bankën tonë.

Kriteret që duhet të plotësohen nga studentët:

- Puna praktike vlen vetëm për kandidatët të cilët janë në studime e sipër;
- Nota mesatare duhet të jetë: min. 7.5/ 10 apo 2.5/ 4 (kërkohen dokumente për ta dëshmuar notën mesatare në rast se ftoheni për intervistë);
- Njohuri të shkëlqyera të kompjuterit dhe të gjuhës angleze;
- Të jetë i/e gatshëm/e të punoj për 3 muaj me orar të plotë (40 orë në javë) prej 1 Janarit-31 Mars, 2010.

Procesi i Aplikimit:

- Ju lutem lexoni të gjitha instruksionet e mëposhtme për mënyrën e aplikimit
- Përgatisni një CV (me të dhënat e juaja të fundit)

Të gjitha aplikacionet për punë praktike pranohen vetëm përmes sistemit tonë online të rekrutimit, duke filluar nga data **05.11.2009**.

Forma e aplikimit duhet plotësuar on-line në webfaqen tonë: www.procreditbank-kos.com, duke klikuar tek “Mundësitë për Punësim”, apo direkt në: <https://job.procreditbank-kos.com/>.

Ju lutemi plotësoni të gjitha fushat e kërkuara në aplikacionin tonë online, duke e bashkangjitur edhe CV-në tuaj, jo më vonë se më **17.11.2009**.

Për çfarëdo informate shtesë që ju nevojitet, ju lutem na kontaktoni.